



Duke u Mbështetur në nenin 40.2 nën c) të LVL nr. 03/L-040 nenit 40 al2 nën pikën 3 të Statutit të Komunës së Klinës dhe rekomandimet e KPF-së, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e X-të të radhës për vitin 2015, të mbajtur më 26.11.2015, mori këtë:

V E N D I M

Për

Miratim të Raportit të menaxhimit financiar komunal për periudhën janar-shtator 2015

I

Miratohet Raporti i menaxhimit financiar komunal për periudhën janar-shtator 2015.

II

Buxheti në SIMFK sipas burimit dhe buxheti i shpenzuar për janar – shtator 2015 ishte:

Buxheti i shpenzuar në periudhën janar – shtator 2015 në vlerë 6,329,245.51 € është rreth 72.20 % e buxhetit në SIMFK për 2015. Nga Granti qeveritar 5,645,751.51 € (75.39 % në raport me buxhetin nga Granti), nga të hyrat vetanake 342,949.68 € (39.98 % në raport me buxhetin nga të hyrat për 2015), nga të hyrat e bartura 311,142.82 € (84.89% në raport me buxhetin nga të hyrat e bartura). Ndërsa nga totali i buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë në vlerë 6,329,245.51 € nga granti qeveritar janë 89.20%, nga të hyrat vetanake 5.42 %, nga të hyrat e bartura 4.92 % dhe nga participimi i qytetarve 0.46%. Shpenzimet e buxhetit në këtë periudhë janë më të larta për rreth 5.00 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Shpenzimet e Buxhetit për periudhën janar-shtator 2015 sipas kategorive ekonomike:

Nga buxheti i shpenzuar në periudhën janar – shtator 2015 në vlerë 6,329,245.51 € për paga dhe meditje janë shpenzuar 4,136,888.13 € (65.36% e shpenzimeve), për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 459,040.08 € (7.25% e shpenzimeve), për shërbime komunale 123,338.08 € (1.95% e shpenzimeve), për subvencione 58,218.55 € (0.92 % e shpenzimeve) dhe për kapitale 1,551,760.67 € (24.52 % e shpenzimeve).

Shpenzimet në periudhën janar-shtator 2015 në vlerë 6,329,245.51 € krahasuar me shpenzimet në periudhën e njëjtë të vitit 2014 në vlerë 6,027,874.40 € janë rritur, rreth 5.00 %. Shpenzimet për paga dhe meditje krahasuar me vitin paraprak janë rritur rreth 10.15%, shpenzimet për mallra dhe shërbime janë zvogluar për 9.09%, shpenzimet për shërbime komunale janë rritur për 15.54 %, shpenzimet për subvencione janë zvogluar për 13.71 % dhe shpenzimet për kapitale janë zvogluar për 2.59 %.

III

Raporti si në pikën 1 të këtij Vendimi miratohet me vërejtjet dhe sugjerimet që janë të përfshira në procesverbalin e Kuvendit të Komunës të mbajtur po në ditën e miratimit me dt.26.11.2015.

IV

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Klinës, ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas pranimi të tij nga autoriteti mbikëqyrës për shqyrtimin e ligjshmërisë, konform nenit 81 të LVL.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr 06-5993 2015
Klinë, më 26.11.2015



KRYESUESI,
Dr. Haxhi Ibishi